



Funded by  
the European Union



MINISTRIA E KULTURËS



© GAN (UK)

## SHTEGU I DYERVE TË VJETRA TË QYTETIT TË DURRËSIT



### Vila Tedeschini

BULEVARDI EPIDAMN

Familja Tedeschini është një familje fisnike me prejardhje nga qyteti Vasto provincë e Kletit në Itali. Vila Tedeschini u ndërtua në vitin 1843 nga vëllezërit Josef dhe Francesko Tedeschini konsuj të Austrisë në Durrës, dhe ka shërbyer edhe si konsullatë austriake duke u njohur për mikëpritjen e shumë diplomatëve të huaj. Një prej emrave të njohur ka qenë edhe albanologu Johan Georg von Hahn. Për shumë vite një pjesë e kësaj vile ka funksionuar si "Farmacia Tedeschini" ku ilaçet janë dhënë falas për njerëzit në nevojë.



### Familja Fani

RRUGA ADMIRAL ABDI MATI

Banesa e tyre u ndërtua në vitin 1932 nga nga dy vëllezërit Hysen dhe Mustafa Fani, tregtarë dhe detarë të njohur të kohës në qytet. E ndërtuar me stiliin liberty dhe neoklasik i vonë shqiptar, shtëpia ishte menduar të kishte dyqane në katin e parë dhe mjedise banimi në katin e dytë. Banesa Fani iu konfiskua pronarëve dhe iu përshatet sipas ligjeve të sistemit komunist në Shqipëri midis viteve 1946-48 dhe pronarët e saj nuk jetuan aty, por banorë të tjerë u vendosën.



### Familja Mima

BULEVARDI DYRRRAH

Bashkëjetesën me qytetin e Durrësit familja Mima, e ka që para vitit 1900. Ndërtuar nga Jovan Mima, brenda saj kanë jetuar 4 breza, deri tek nipërit dhe mbesat që jetojnë ende sot.

Kjo banesë i rezistoi tërmetit të 1926, dhe vijon të mbetet origjinale ende sot.

Ndoshta pak e njohin aktorin shqiptar Prokop Mima, i cili lindi dhe kaloi fëmijërinë e tij në këtë shtëpi.



### Pranë Kishës Shën Luçia

BULEVARDI EPIDAMN II

Nëse pyesim sot veten, ku ndodhet lagjja e njohur "Kala", atë e gjejmë përmes objekteve ikonike identifikuese.

Nëse bëni një ecje rreth përmes Xhamisë Fatih, aty do njiheni se dikur në mesjetën e hershme gjendej një kishë bizantine e cila gjatë pushtimit otoman u shndërrua në xhami për nder të sultan Mehmetit II, Fatihut. Përshkoni rrugën dhe afrohuni pranë Kishës katolike të Shën Luçisë e pajisur me këmbanore bashkë me lëshëkëvinë.

Pranë kësaj hapësire kanë jetuar familje të rëndësishme si: Çelkupa, Tedeskini, Kurti, Hoxha, Bumçi, Parga e Beja.



### Familja Nushi

Rr.MUSTAFA VAROSHI

Dikur tregtar në vende të ndryshme si Itali, Greqi e gjatë djali me origjinë nga Berati, Jani Nushi vendoste rrënjët e tij në Durrës. Si një familje e madhe me tetë fëmijë, pasardhësit e tij do të fitonin profesione si në farmaci ashtu edhe në arkitekturë, ekonomi, mësuesi, dhe sport.

Ndërmjet luftës, plaçkitjes dhe lakmisë vila transformohet në fillimet e 1916 herë në spital e herë si vendstrehim nga forcat austro-hungareze.

Dikur një banesë ikonike, e mbushur me ecjet e zërat e familjarëve e nipërve që luajnë në oborrin e saj, tashmë gjendet e braktisur, e zbratur, pa e ditur fatin e saj të ardhshëm.



### Familja Elezi

RRUGA KASEM DURRESI

Banesa e Haxhi dhe Zija Elezi është ndërtuar rreth viteve 1928-30. Pas çlirimit të vendit, e gjithë lagjja u kthye në zonë ushtarake, kështu pronarët u nxorën nga banesat e tyre, dhe aty u strehuan ushtarakët, që vinin nga qytetet dhe fshatrat e Shqipërisë.

Shtëpia mbraja kishte një oborr të madh të mbjellur me fruta nga më të ndryshmet. Shpesh pranë oborrit organizoheshin dreka dhe lojra të ndryshme dhe oborri shndërrohej në një qendër për kalimin e kohës së lirë të vajzave të lagjes. Në atë kohë nuk dispononin të gjithë radio!

"Ne kishim një radio Magnadyne, ku mësonim të vallëzonim"...



### Familja Bilali

RRUGA EGNATIA

Familja Bilali, ishte me origjinë nga Ulqini i Malit të Zi. Pasi jetoi në Shkodër për disa muaj, ajo u vendos në përfundimisht në Durrës dhe këtu tre vëllezërit e familjes ndërtuan pronën e tyre. Të njohur si tregtarë me speditonin detar të motovelierave, ata mbanin krenarisht flamurin shqiptar në linjat me Jugosllavinë. Banesa e ndërtuar vitin 1931, funksiononte edhe si mjedis tregtar në katin e parë, ndërsa katet e dyta ishin projektuar për banim. Periudha e errët e komunizmit dhe Partia e Punës i largoi pronarët e saj nga shtëpia dhe i persekutoi.



### Familja Koja dhe Jakoel

RRUGA GLAUKIA

Banesa e jetuar nga Familja hebreje Jakoel dhe familja shqiptare Koja, tregon edhe për bashkëpunimin e ndërsjellë të mirëkuptimit midis tyre. Sipas protokolleve dhe normave të Kodit Civil të kohës duhej që hapësirat të ishin 140 m<sup>2</sup>, ndaj të dyja familjet dakordësuan të bashkonin hapësirat midis tyre. Ndërtesa është ndërtuar nga arkitektë Italianë dhe në atë kohë u banua nga individë që tregtonin stofra dhe basme.

Me ardhjen e sistemit komunist ndërtesa u shtetëzua, dhe brenda saj u vendosën banorë të tjerë.



### Familja Toska-Bodiken

Rr.MUSTAFA VAROSHI

Me origjinë nga Berati, por me rrënjë armene, familja e Aleks Toska Bodiken e ngriti banesën e tij në vitin 1937.

E ndërtuar për gjashtë javë si një sfidë me punëtorët e ndërtimit, banesa u ndërtua për të shërbyer në katin e parë për ambiente tregtie, ndërsa kati i dytë për banim.

Ata zgjodhën Durrësin për të shpëtuar gjënocidit armen dhe këtu formuan strehëzën e re, larg atdheut.



### Familja Barushi-Subashi

RRUGA ENVER ZAZANI 12-14

Ajo u ndërtua nga Ibrahim Subashi, jo për banim por si rezidencë. Pasi tërmeti i 1926 shkatërroi qytetin, për ndërtimin e saj në 1928 u punësuan inxhinierë italianë të cilët përveç teknikës antisizmike zbatuan edhe dekorimin arkitekturor fashist të kohës. Banesa prej tre katesh u plotësua edhe me dy dyer në formë harqesh në material të hekurit, që u gdhendën nga artizanë dhe hekurpunues të ardhur nga Bari i Italisë. Ndonëse banesa iu nënshtrua konfiskimit dhe ndryshimit strukturor të brendshëm, gjatë regjimit komunist pronarët e familjes u dëbuan. Kati i fundit i banesës lidhet ngushtë edhe me emrin e një prej qytetarëve më të njohur të qytetit mjekun Dr. Cara.



### Familja Jorgji

BULEVARDI EPIDAMN

Dikur pranë banesës së Mantho Jorgjit gjendej Porta e Jallisë, porta hyrëse e qytetit nga ana e detit. E ndërtuar shpejt për dy vite nga arkitekti Kristo Sotiri, ajo ishte gati të priste familjarët e ekonomistit në vitin 1932. Dy luanët prej graniti që dekoronin vilën u hoqën nga vila, ashtu siç u larguan gjatë komunizmit edhe pasardhësit nga foleja e tyre.

Dikur e jetuar nga katër breza, ajo ka pritur inxhinierët e parë jugosllav, që u strehuan gjatë ndërtimit të hekurudhës së parë shqiptare. Një tjetër figurë artistike si shkrimtari dhe dramaturgu Minush Jero banoi gjatë aty.

Ndërsa pas viteve 1990 u bë strehë arti për galerinë e arteve të Durrësit. Sot, ajo ka mbetur e vetme, por ende mbetet madhështia e detajeve të gdhendura mbi sipërfaqen e fasadës.



### Familja Veli

SHESHI LIRIA

E ndërtuar nga dy kushërinj Ramazan dhe Hysen Veli në vitet 1937-38, godina u mendua dhe u projektua që në fillim si një qendër tregtare, aq sa brenda saj edhe sot ruhet ashensori original. Të gjithë pasuria e tyre u konfiskua dhe u përdor nga regjimi për funksione të tjera.

Nga 1945 deri në vitin 1970 ka qenë selia e Komitetit të Partisë. Nga 1970 deri në vitin 1990 ka funksionuar si Hetuesia e Durrësit.

Nga viti 1994 deri në vitin 1996 në të u vendos shoqëria e tragjetit "La Vichinga".

Gjatë luftës së Kosovës 1998-1999 godina u shndërrua në selinë e Kryqit të Kuq Belg.

Prej vitit 2000 deri para pak vitesh ka shërbyer si vendndodhja e televizionit të parë privat të qytetit të Durrësit "TV Teuta". Aktualisht godina është e mbyllur pa asnjë funksion.

## Mirësevini në Shtegun Kulturor të 12 Dyerve të Vjetra të qytetit të Durrësit!

Ky shteg është krijuar si pjesë e projektit "Kur e kaluara takohet me të ardhmen - rivitalizimi i trashëgimisë kulturore të Durrësit", zbatuar nga Qendra Durrësi Aktiv në bashkëpunim me MuZEH Lab, në kuadër të programit EU4Culture të financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga UNOPS në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës.

Objektivi ynë i përgjithshëm është të rivitalizojmë monumentet e Durrësit duke lidhur kujtesën kolektive të qytetit me trashëgiminë e tij arkeologjike dhe duke krijuar atraksione të reja kulturore, si dyert e shekujve 19 dhe 20. Në bashkëpunim me komunitetin e artizanëve, këto dyer i kemi sjellë në jetë me mjeshtëri unike dhe artistike, duke synuar të ringjallim jehonat e së shkuarës.

Nëpërmjet punimeve artizanale, eventeve kulturore, gjurmës kulturore dhe fuqizimit të artizanëve, kjo hartë do të kontribuojë në rritjen ekonomike dhe krijimin e mundësive për qytetin e Durrësit. Dyert, të punuara me shtiza dhe grep janë krijuar nga artizanët: Ezmerina Kasa, Liljana Arifaj, Myzejen Rexhepi, Lumturije Kasa dhe Manushaqe Arifaj. Për t'i vizituar këto vepra mund t'i gjeni përgjatë shtegut kulturor, në Qendrën Aktiv Durrës, muzeun MuZEH Lab dhe Bashkinë Durrës.

Kjo hartë e printuar synon t'ju ofrojë informacion thelbësor për shtegun kulturor të 12 dyerve në Durrës. Ai do t'ju udhëheqë nëpër qytet, duke nxjerrë në pah monumente të rëndësishme, vende historike dhe atraksione kulturore gjatë rrugës. Ndërsa eksploron shtegun, do të zhyteni në historinë e pasur dhe kulturën e gjallë të Durrësit. Zbuloni historitë e familjeve pas çdo dere, vlerësoni mjeshtërinë e ndërlikuar dhe dëshmoni shkrirjen e së shkuarës dhe së tashmes.

Së bashku me hartën fizike, do të gjeni shtegun kulturor edhe online në faqen [www.theolddoorstrail.com](http://www.theolddoorstrail.com)


Për të gjetur vendodhjen ekzakte të derës kërkoni me emrin e familjes në google map.

Ju ftojme të nisni këtë rrugëtim kulturor, duke u lidhur me trashëgiminë e Durrësit dhe duke mbështetur artizanët vendas. Shijoni shtegun dhe lërinë dyert antike të Durrësit të zbulojnë sekretet dhe bukurinë e tyre para jush.

Lidhu me Qendrën Durrësi Aktiv  
<https://durresiaktiv.al>

Lidhu me muzeun MuZEH Lab  
<https://muzehlab.org/>

Disa nga dyert e punuara nga artizanet



Scan me!

